

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

RTL TRANSPORT & LOGISTICS AL

Me ane te ketij dokumenti sot me date 26 prill 2022

z. Guido Rutilli i lindur me 22/11/1964 ne Bozzolo (MN), rezident ne 46100 Vicolo San Paolo 14, Mantova (MN), qytetar italian, titullar i kartes se identitetit Nr. CA48209AA

Vendos sa me poshte vijon :

1. Te themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar te emertuar **RTL TRANSPORT & LOGISTICS AL**, Ortak i Vetem.
2. Shoqeria **RTL TRANSPORT & LOGISTICS AL** eshte nje person juridik i te drejtes shqiptare qe operon si e tille nga dita e regjistrimit ne regjistrin tregetar prane Qendres Kombetare te Biznesit. Aktiviteti i saj do te rregullohet konform dispozitave te ketij Akti, te Statutit bashkangjitur dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi.
3. **Kohezgjatja** e aktivitetit fiksohet deri me 31 Dhjetor 2050, por mund te shtyhet nga Asamblea e pergjithshme.
4. Shoqeria ka per **objekt** te aktivitetit te saj : Transport kombetar dhe nderkombetar rrugor te mallrave per te trete me mjetet e veta dhe te marra me qira.
5. **Selia** e shoqerise vendoset ne Durres, Lagja nr.3, Bulevardi Epidamn, Zona Kadastrale 8514, objekt me Nr.pasurie 3/198, kati i dyte.
6. **Kapitali shoqeror** fillestar eshte ne vleren 612.000 leke (gjashteqindedybedhjetemije), i perbere nga 1 kuote dhe 100% ne zoterim te Ortakut te Vetem, **z. Guido Rutilli**.
7. **Administrimi** dhe perfaqesimi i shoqerise i besohen nje Administratori te Vetem, qe mund edhe mos te jete ortak. Administratori i Vetem emerohet per maksimumi 5 vjet, pervec rasteve kur jep doreheqjen ose shkarkohet nga Asamblea e pergjithshme.

Administrator i Vetem emerohet **z. Endri Kryeziu**, i lindur ne Durres (AL), me 14/05/1990, i identifikuar me nr.personal J00514080M rezident Lagja nr. 5 Rruga Mujo Ulqinaku Durres (AL), qytetar shqiptar, titullar i kartes se identitetit Nr. 033859654, te cilit i jepet e drejta e firmes dhe e perfaqesimit te shoqerise.

Administratori i Vetem ka te gjithë kompetencat per realizimin e objektit te shoqerise, me perjashtim te kompetencave te dhena nga ky Akt dhe nga Statuti ekskluzivisht Asamblese se Pergjithshme.

Administratorit i kufizohet e drejta për të kryer operacione bankare në emër të shoqërisë pa miratimin e Asamblesë së Përgjithshme të tilla si: transferta bankare, urdhërpagesa, tërheqje bankare cash, arkëtime dhe pagesa, por pa u kufizuar vetem në to, me ose pa para ne dore, deri në shumën mujore prej 750.000 lekë (shtatëqindpesëdhjetë mijë).

Administratori i ndalohet të transferojë, shesë, pjesërisht ose tërësisht aktivet në pronësi të shoqërisë, apo çdo aktiv tjetër, të dobishëm për arritjen e qëllimit të shoqërisë, pa miratimin e Asamblesë së Përgjithshme.

8. Viti ekonomik ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.
Viti i pare ushtrimor mbyllet me date 31 Dhjetor 2022.
9. Ne perfundim te vitit ushtrimor, pas aprovimit te bilancit, Asamblea mund te vendose shperndarjen e fitimit neto. Ky fitim mund te transferohet lirisht jashte Shqiperise konform legjislacionit ne fuqi. Per humbjet shoqeria pergjigjet ekskluzivisht me kapitalin e saj.
10. Ortaku dhe administratori jane te detyruar te ruajne konfidencialitetin mbi dokumentacionin, te dhenat, njohurite dhe eksperiencat e fituara gjate aktivitetit te shoqerise, si dhe te marre te gjitha masat e nevojshme te sigurise per te evituar perhapjen e tyre, qofte edhe pjesore.
Ata jane pergjegjes per pasoja te mundshme negative nga shkelja e persa me siper thene.
11. Persa nuk specifikohet shprehimisht ne kete akt, vlejne normat e Statutit bashkangjitur.
12. Aktit te Themelimit ne gjuhen shqipe do t'i bashkangjitet kopja ne gjuhen italiane.

ORTAKU I VETEM

Guido Rutilli

Perktheu : **BESIM TUSHA**